



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 20 datë 29.4.2024

**“PËR NJË SHITESË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË
SHKODËR PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI I KOMUNITETIT PËRMES OFRIMIT
TË SHËRBIMEVE DITORE TË ALTERNUARA PËR FËMIJËT DHE
FAMILJEN”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqerisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave nr 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datw 04.12.2017 “Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”; Marrëveshja Standarte Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024, mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”. si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesën e planit dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.
2. Projekti financohet në kuadër të “Leave No One Behind (LNB) – “Askush të mos mbetet pas”, udhëhequr dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri – *UNDP Albania*, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për të mbështetur projekte në fushën e shërbimeve shoqërore me bazë komunitare të propozuara nga çdo bashki në Shqipëri.
3. Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 4,052,492 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe kontributi i Bashkisë Shkodër për projektin.
4. Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,997,500 Lekë (73.97%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
5. Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 1,054,992 lekë. 26.03%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
6. Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Shpenzimet e llogaritura					
	Totali (Lek)	Nga kjo:			
		Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzim e Kapitale
Shuma 2024	2,377,500	613,000	107,000	1,397,500	260,000
Shuma 2025	620,000	306,000	54,000	260,000	
Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti	2,997,500	919,000	161,000	1,657,500	260,000
Totali	2,997,500	919,000	161,000	1,657,500	260,000

7. Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2024 dhe 2025.
Projekti ka parashikuar të punësojë dy mësues mbështetës (part-time) 50% sipas angazhimit, i cili do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025.
Fondi i përllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.
Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Punonjës	I	Arsimi i lartë	Arsimi i mesëm
----------	----------	---	----------------	----------------

		zgjedhur, I emëruar	Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	2		IV-a	56,000		
Numri i Punonjësve	2					

Mësuesit mbështetës (part-time) do punojnë me kohë të pjesshme me 50% të kohës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 33 vota
Vota Pro 33
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 7.5.2024